

PROCESVERBAL
nga seanca e shtatëmbëdhjetë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 5.11.2025

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavilovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Emilija Janevska, mr. Magdalena Davidovska-Dovleva, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e shtatëmbëdhjetë të Këshillit. Seanca filloi në ora 13:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 16-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 3.11.2025.
2. Raport për transmetim të reklamimit të paguar politik gjatë kohës së rrethit të parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet lokale 2025.
3. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërimit publik të operatorit "Neotel" nga Shkupi, për shkelje të nenit 141 të LShMAAV.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar të seancës së 16-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 3.11.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Drejtori Trajçevski shpjegoi Raportin mbi transmetimin e reklamimit të paguar politik gjatë kohës së rrethit të parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet lokale 2025. Ai shpjegoi se Raporti i referohet periudhës nga 29 shtatori deri më 17 tetor 2025 dhe është përgatitur në bazë të detyrimit të përcaktuar në nenin 76-d paragrafi (8) të Kodit Zgjedhor. Në përputhje me dispozitën ligjore, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (AShMA) është e detyruar në ditën e 20-të para fillimit të heshtjes zgjedhore t'i paraqesë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) raport mbi transmetimin e reklamimit të paguar politik për radiodifuzerët. Përgatitja e Raportit kryhet sipas procedurave të përcaktuara në mënyrë strikte, gjatë të cilave kontrollohen të gjitha të dhënat e nevojshme mbi përmbajtjet e transmetuara. Pas përfundimit të kontrollit, në stacionet televizive dhe radio u jipen çertifikata për transmetimin e reklamave politike me pagesë, duke siguruar kështu transparencë dhe pajtueshmëri me detyrimet ligjore. Në përputhje me dispozitat ligjore, transmetuesit që kanë aplikuar për transmetim të reklamave politike me pagesë janë të detyruar të regjistrohen në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) për të fituar të drejtën për të transmetuar këto përmbajtje. Për këto zgjedhje, në KSHZ u regjistruan gjithsej 33 stacione televizive dhe 42 radio. Për të lehtësuar zbatimin e Kodit Zgjedhor, përkatësisht për të përcaktuar se sa kohë mund të ndahet për reklamim politik me pagesë për subjekt politik brenda një ore reale, AShMA miratoi Udhëzim për reklamim të paguar politik për zgjedhjet 2025. Sipas Raportit, nga gjithsej 75 transmetues të regjistruar, në rrethin e parë të fushatës zgjedhore, 68 media transmetuan reklamim të paguar politik, përkatësisht 33 stacione televizive dhe 35 radio. Në total, të gjithë transmetuesit, radio dhe televizione së bashku 562 orë, 37 minuta dhe 53 sekonda reklamim të paguar politik, që përfaqëson një vëllim të konsiderueshëm dhe mbresëlënës të reklamimit politik gjatë kohës së fushatës zgjedhore. Nga nëntë televizionet kombëtare që nënshkruan kontratë për transmetimin e reklamave politike me pagesë, vëllimi më të madh të reklamave transmetuan televizionet "Kanali 5", "Alsat M" dhe "TV Kompani 21-M". Ndër radiot kombëtare, reklamim politik me pagesë më së shumti u transmetua nga "Antena 5" dhe "Kanal 77". Raporti mbulon gjithashtu televizionet dhe radiot lokale dhe rajonale që transmetojnë reklamim të paguar politik gjatë kohës së fushatës zgjedhore. Sipas të dhënave, në televizione kohë më të madhe për reklamim morën koalicionet e udhëhequra nga partitë VMRO-DPMNE dhe BDI, ndërsa në radio vëllim më të madhë për reklamim të paguar politik kishin koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe koalicioni i udhëhequr nga LSDM. Në përputhje me Udhëzimin për reklamimin e paguar politik, të hartuara në përputhje me Kodin Zgjedhor, vëllim më të madh të reklamave të paguara politike kishin dy partitë më të mëdha në pushtet dhe dy partitë më të mëdha në opozitë. Në kuadër të kohës së lejuar për reklamim të paguar politik, në periudhën prej një minute për orë reale, u përfshinë tre parti politike që kanë deputet në Parlament, që nuk kanë formuar grup parlamentar. Përveç kësaj, në kohëzgjatje prej 30 sekondash për orë reale u përfshinë kandidatët e pavarur për kryetar bashkie, listat e paraqitura të këshilltarëve, si dhe kandidatët e partive politike që nuk janë të përfaqësuara në parlament. Raporti tregon se dy parti politike, Levica dhe Lëvizja ZNAM - Për Maqedoninë Tonë, nuk kishin mundësi të transmetojnë reklama politike me pagesë për shkak të mospërputhjeve ligjore dhe lëshimeve që ekzistojnë në Kodin Zgjedhor. Afati për dorëzimin e Raportit për reklamim të paguar politik, i cili aktualisht është duke u shqyrtuar nga Këshilli, skadon nesër, dhe duhet t'i dorëzohet KSHZ-së. Kjo do të mundësojë fillimin e procedurës për pagesën e mjeteve (fondeve) ndaj radiodifuzerëve për transmetim të reklamave politike me pagesë.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, iu referua prezantimit të drejtorit, dr. Zoran Trajčevski, lidhur me, siç e quajti, "numrin mbresëlënës të orëve të transmetimit të reklamave politike me pagesë (RPP)", dhe kërkoi sqarime nëse kjo është një rritje në krahasim me proceset e mëparshme zgjedhore.

Drejtori Trajčevski sqaroi se koha totale e transmetimit të reklamave politike me pagesë nuk është më e madhe se në zgjedhjet e mëparshme, por se edhe mëtej kemi të bëjmë me numër jashtëzakonisht të madh orësh, karakteristikë për të gjitha proceset zgjedhore. Ai theksoi se ky vëllim reklamash rezulton në burime të konsiderueshme financiare të ndara nga buxheti i shtetit, duke treguar se për këtë vit zgjedhor shuma tejkalon shtatë milionë euro.

Këshilltarja Cvetanka Minovska vazhdoi lidhur me pyetjen e kryetarit dhe kërkoi nga drejtori të jepte të dhëna mbi numrin total të orëve të transmetimit të reklamave politike me pagesë në kuadër të zgjedhjeve të mëparshme parlamentare ose lokale, me qëllim kryerjen e një analize krahasuese.

Drejtori Trajčevski informoi se Agjencia i posedon të gjitha të dhënat relevante, që përmbajn raportet për RPP nga proceset e mëparshme zgjedhore dhe se ato janë të disponueshme për publikun në ueb-faqen e Agjencisë. Ai njoftoi se pas përfundimit të seancës, raportet do t'u dërgohen me e-mail të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Raportin mbi reklamën politike me pagesë gjatë kohës së rrethit të parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet lokale 2025, në periudhën nga 29 shtator deri më 17 tetor 2025, nr. 10-4727/1 datë 4.11.2025, me tekstin e propozuar.

Pas votimit të kryer, rryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, theksoi se shërbimi profesional i Agjencisë duhet Raportin për transmetim të reklamave të paguara politike gjatë kohës së rrethit të parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet lokale 2024 t'ia dorëzojë KSHZ dhe ta publikon në ueb-faqen zyrtare të AshMA-së.

Pika 3

Drejtori dr. Zoran Trajčevski shpjegoi propozimin për shqiptimin e masës paralajmërim publik të operatorit "Neotel" nga Shkupi, për shkak të shkeljes së nenit 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV). Në shpjegim, drejtori tregoi se gjatë monitorimit të kryer, është përcaktuar se operatori ka ritransmetuar dy shërbime programore që nuk mbulohen me çertifikatë të dhënë nga Agjencia. Duke pasur parasysh se kjo është shkelja e parë në vitin aktual, propozohet të shqiptohet masë paralajmërim publik dhe operatori urdhërohet që menjëherë të ndërpresë me ritransmetim të shërbimeve programore që nuk janë në përputhje me çertifikatat e dhëna. Pas skadimit të afatit të përcaktuar, sektori kompetent të kryejë mbikëqyrje kontrolli me qëllim që të përcaktohet nëse operatori ka vepruar në përputhje me nenin 141 të LShMAAV.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të rregullt programore nr.11-4694/1 datë 3.11.2025 dhe njëzëri konstatoi t'i shqiptohet masë paralajmërim publik Shoqërisë për telekomunikacion dhe shërbime "Neotel" SHA eksport-import Shkup për shkelje të nenit 141, paragrafi (13) të LShMAAV. Në përputhje me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (tekst i pastruar) nr. 1-4241/1 datë 1.10.2025, urdhëroi që menjëherë pas pranimit të Aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat ligjore.

Nga mbikëqyrja u konstatua se Shoqëria për telekomunikacion dhe shërbime "Neotel" SHA eksport-import Shkup, e cila sipas notifikacionit të Agjencisë për Komunikime Elektronike mund të ushtrojë veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 31.10.2025, për shfrytëzuesit e saj ka ritransmetuar shërbimet programore "Kompania 21-M" dhe "Da Vinçi", të cilat nuk përfshihen me çertifikatë për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim me nenin 141 paragrafi (13) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të Shoqërisë për telekomunikacion dhe shërbime "Neotel" SHA eksport-import Shkup.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin ta publikojë në ueb-faqe të Agjencisë.

Pas votimit të kryer, kryetari i Këshillit mr. Sasho Stefanovski, tregoi detyrimin e shërbimeve profesionale – Aktvenimin për paralajmërim publik dhe për përjashtim nga ritransmetimi të shërbimeve programore t'i dorëzohen Agjencinë për Komunikime Elektronike të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për paralajmërim publik, shërbimet janë të detyruara të kryejnë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktohet nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar në përputhje me masën e shqiptuar dhe e ka harmonizuar punën e tij me dispozitat ligjore.

Pika 4

Të ndryshme

Këshilltarja Gordana Majnova informoi se është publikuar Raporti i progresit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025, i përgatitur nga Komisioni Evropian, dhe pyeti nëse është praktikë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale të përgjigjej ndaj pretendimeve të përfshira në Raport. Ajo theksoi se në dokument janë shënuar disa konstatime që sipas saj, nuk ishin plotësisht në përputhje me situatën reale dhe pyeti nëse Agjencia paraqet përgjigje oficiale ose shpjegim zyrtar për ato pjesë. Këshilltarja iu referua konkretisht pjesës që lidhet me lirinë e shprehjes dhe faqes (Freedom of expression) dhe faqes 38 të Raportit, ku thuhet:

„In June 2025, the Parliament selected the new members of the Agency's Council. Concerns were raised about the way the members of the Agency's Council were selected due to a lack of transparency, clear criteria and impartiality.“

Këshilltarja Majnova kërkoi sqarime nëse Agjencia u përgjigjet akuzave të tilla – paragraf pas paragrafi – apo në përgjithësi, dhe sugjeroi nëse jepet një përgjigje, të shënohet se anëtarët e Këshillit janë zgjedhur në mënyrë transparente, sipas kritereve të përcaktuara qartë dhe në përputhje me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në mënyrë që të jepet një shpjegim i saktë dhe i arsyetuar. Ajo kërkoi ndjesë që dokumenti aktualisht është i disponueshëm vetëm në anglisht.

Drejtori dr. Zoran Trajčevski shpjegoi se Raporti i progresit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025, i përgatitur nga Komisioni Evropian, është dokument përfundimtar i Unionit Evropian i cili, pavarësisht nëse Agjencia ka apo jo komente, nuk i

nënshtrohet ndryshimeve pas publikimit të tij. Ai theksoi se, në rastet kur Agjencia ka qëndrime ose komente të kundërta në lidhje me përmbajtjen e Raportit, qasja më e përshtatshme është të mbahet takim me Delegacionin e Unionit Evropian në Shkup, në të cilin do të prezantohen argumente dhe sqarime në lidhje me komentet.

Këshilltarja Gordana Majnova vazhdoi duke shprehur iniciativën për të organizuar takim me Delegacionin e UE-së, veçanërisht në pjesën ku thuhet se Republika e Maqedonisë së Veriut nuk është në përputhje të plotë me direktivat evropiane dhe Aktin Evropian për Lirinë e Medias, me theks në çështjen e përqendrimit mediatik dhe ndikimin e tij mbi pluralizmin mediatik. Ajo shtoi se nuk është vetëm një paragraf i vetëm, por disa konstatime në Raport për të cilën duhet të kenë reagim ose shpjegim shtesë nga Agjencia.

Drejtori Trajčevski u pajtua dhe informoi se në ditët në vijim do të organizohet një takim me Delegacionin e Unionit Evropian në Shkup, me qëllim shqyrtimin dhe sqarimin e të gjitha pjesëve relevante të Raportit.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli bëri një pyetje drejtorit dr. Zoran Trajčevski në kontekst të seancës së 14-të, në lidhje me procedurën e inicuar kundërvajtëse kundër "TV Kompani 21-M". Ajo shpjegoi se drejtuar Këshillit kishin mbëritur dy e-maile nga "TV Kompani 21-M", dhe kërkoi informacion në lidhje me rrjedhën dhe rezultatin e procedurës kundërvajtëse. Këshilltarja theksoi se nuk kishin marrë asnjë përgjigje nga Agjencia, prandaj kërkoi sqarim nëse dhe kur do t'i dorëzoheshin informacione zyrtare "TV Kompanisë 21-M" dhe anëtarëve të Këshillit.

Drejtori dr. Zoran Trajčevski shpjegoi se pasi u morën vendimet e gjykatës në lidhje me procedurat kundërvajtëse, së bashku me kryetarin e Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, zëvendësen e kryetarit të Këshillit mr. Zirjeta Jajaga dhe Këshilltaren Cvetanka Minovska, diskutuan për situatën. Ai informoi se për dy radiodifuzer - televizioni "TV kompani 21-M" dhe televizioni "Shutel", u shqiptua masë paralajmërim publik, ndërsa për dy radiodifuzer – "TV-24" dhe televizioni "Vistel", u liruan nga kundërvajtja. Lidhur me "TV-24" dhe "Vistel", drejtori tregoi se Agjencia kishte paraqitur ankesë, pasi afati për ankesë ishte 24 orë nga marrja e aktvendimit. Për "TV Kompani 21-M" dhe "TV Shutel", gjykata i pranoi masat e shqiptuara nga Agjencia sepse veproi në përputhje me Ligjin, por për të shmangur dëmin material, meqenëse gjambat për këta dy transmetues janë dukshëm të larta, gjykata u dorëzoi paralajmërim me qëllim mbrojtjen e interesave materiale të subjekteve dhe Agjencia e pranoi vendimin e gjykatës.

Zëvendësja e kryetarit mr. Zirjeta Jajaga, informoi se gojarisht është informuar për rrjedhën e procedurave, por kërkoi që t'i jepet informacion me shkrim për gjendjen e tyre aktuale. Ajo propozoi që anëtarët e Këshillit të përfshihen në komunikimin elektronik midis shërbimeve dhe operatorëve, me qëllim që rregullisht të informohen për rrjedhën e procedurave.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli vazhdoi dhe theksoi se anëtarët e Këshillit shpesh nuk kanë informacion kthyes për vendimet që marrin në seancë, pavarësisht nëse ato i referohen paralajmërimi publik apo inicim të një procedure kundërvajtëse. Ajo theksoi se mediat ndonjëherë kërkojnë mirëkuptim, duke deklaruar se bëhet fjalë për mosveprim ose vështirësi financiare, por Këshilli nuk ka informacion mbi mënyrën se si Agjencia iu përgjigjet rasteve të tilla. Këshilltarja propozoi që anëtarët e Këshillit të informohen rregullisht për rrjedhën e procedurave dhe vendimet e marra, përkatësisht të përfshihen në komunikim elektronik ndërmjet shërbimeve dhe operatorëve, t'u përcillen mesazhet e duhura elektronike ose të

krijohet një mekanizëm i përshtatshëm për shkëmbimin me shkrim të informacionit. Qëllimi i këtij propozimi është të sigurojë transparencë më të madhe dhe informim në kohë për anëtarët e Këshillit në procesin e mbikëqyrjes dhe vendimmarrjes.

Drejtori dr. Zoran Trajčevski tha se nuk ishte plotësisht e qartë kërkesa, sepse diskutimi filloi me pyetje në lidhje me televizionin, dhe më pas kaloi në vendimin e marrë në lidhje me operatorin "Neotel".

Këshilltarja Afrona Vërzivolli sqaroi se kërkesa për informacion më të detajuar nuk referohet për median në fjalë ose operator, por për të gjithë transmetuesit dhe operatorët. Ajo theksoi se çdo kërkesë ose përgjigje, si dhe çdo masë e shqiptuar nga Këshilli, së bashku me të gjithë shkresat që shërbimi profesional i dërgon te operatorët, duhet rregullisht me shkrim t'u dorëzohen anëtarëve të Këshillit, me anë të postës elektronike e-mail, në mënyrë që të sigurohet transparencë e plotë dhe informacion në kohë në lidhje me të gjitha vendimet e marra dhe procedurat e ndërmarra.

Drejtori dr. Zoran Trajčevski shpjegoi se masat që shqiptohen ndaj operatorëve, si "Neotel" në seancën aktuale ose "Viva Net" në seancën e mëparshme, zbatohen në mënyrë identike për të gjithë operatorët. Ai theksoi se operatorëve u dorëzohet aktvendim me shkrim për masën e shqiptuar paralajmërim publik nga Këshilli, dhe i njëjti aktvendim, së bashku me raportin e mbikëqyrjes, publikohet në ueb-faqen e Agjencisë. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në *Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë*, i cili ndryshon në varësi të llojit të kundërvajtjes, kryhet mbikëqyrje kontrolli. Për rezultatet e mbikëqyrjes së kontrollit Këshilli informohet nëpërmjet e-mail dhe raporti publikohet në ueb-faqen e Agjencisë. Në mesazhin e dërguar operatorit shënohet nëse ka vepruar ose nuk ka vepruar sipas masës së shqiptuar. Nëse operatori nuk vepron brenda afatit të përcaktuar, në seancën e ardhshme të Këshillit përfshihet si pikë e rendit të ditës për iniciimin e procedurës kundërvajtëse, me ç'rast Këshilli informohet plotësisht për rrjedhën e mëtejshme të procedurës.

Drejtori Trajčevski theksoi se për transmetuesit gjatë kohës së procesit zgjedhor, gjykata është e detyruar të vendosë sipas ankesës së pranuar për kundërvajtje brenda 48 orësh. Në rastin konkret, gjykata mori vendime për katër transmetues: dy prej tyre u shqiptuan masa, ndërsa dy të tjerët u liruan nga përgjegjësia. Vendimet arritën në Agjenci në orën 11:40 të paradites, dhe shërbimi kishte 24 orë për t'iu përgjigjur gjykatës. Për stacionet televizive të liruara nga përgjegjësia, Agjencia paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit. Trajčevski theksoi se, meqenëse aktualisht nuk ka ankesa të reja për kundërvajtje, Këshilli do të informohet për të gjitha procedurat për aktvendimet e pranuar, si dhe për nevojën për të paraqitur ankesa, nëse është e aplikueshme. Ai shtoi se, për procedurat e rregullta për kundërvajtje, gjykata ndonjëherë vendos edhe pas një ose dy vitesh, në rastin e zgjedhjeve, afatet janë dukshëm më të shkurtra (24 dhe 48 orë). Këshilli do të vazhdojë të jetë plotësisht i informuar për rrjedhën e të gjitha procedurave, aktvendimeve të marra dhe ankesave të paraqitura, në përputhje me afatet dhe llojin e procedurës.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Mr. Sasho Stefanovski**

